

VENDIM
Nr. 238, datë 23.4.2014

PËR SHPALLJEN E LAGUNËS SË KARAVASTASË SI ZONË BASHKËMENAXHUESE E PESHKIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 54 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e lagunës së Karavastasë si zonë bashkëmenaxhuese e peshkimit, duke pasur parasysh statusin mbrojtës të lagunës, si pjesë e Parkut Kombëtar Divjakë - Karavasta e zonë natyrore, veçanërisht e mbrojtur, dhe si habitate të shpendëve ujorë, të përfshirë në listën e Konventës Ramsar.

2. Veprimtaritë dhe investimet që do të kryhen në lagunën e Karavastasë të jenë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, dhe me objektivat e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar Divjakë - Karavasta.

3. Plani i bashkëmenaxhimit për lagunën e Karavastasë miratohet me urdhër të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, brenda 12 muajve nga data e miratimit të kësaj zone.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama